

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Ushqimi falas në shkolla



Shkurt 2025

Përmbajtja

Rreth sondazhit

3

1

Demografia	3
Rezultate	5
Rekomandime	12
Aneks I – Shkollat ku është zhvilluar anketimi	13
Aneks II – Pyetësi i sondazhit	14

Rreth sondazhit

Në kuadër të reformave arsimore dhe sociale, pritet të zbatohet një nismë e re në shkollat publike 9-vjeçare të Tiranës, posaçërisht për klasat 1-5 dhe ato parashkollore. Projekti synon të ofrojë ushqim falas për nxënësit dhe të zgjasë qëndrimin e tyre në institucionet arsimore deri në orën 16:00. Kjo iniciativë synon të përmirësojë mirëqenien e fëmijëve, të mbështesë familjet me angazhime të shumta dhe të krijojë një ambjent më të strukturuar për të nxitur zhvillimin akademik dhe social të nxënësve.

Me qëllim vlerësimin e opinionëve dhe rekomandimeve të prindërve mbi këtë iniciativë të re, është realizuar një sondazh në disa shkolla publike të Tiranës. Ky studim synon të analizojë pritshmëritë e komunitetit shkollor, përfitimet e mundshme të nismës, si dhe sfidat që mund të shfaqen gjatë zbatimit të saj. Në veçanti, fokusi do të jetë në ndikimin e programit në cilësinë e arsimit, mirëqenien fizike dhe psikologjike të nxënësve, si dhe lehtësimin e ngarkesës për familjet.

Ky raport do të prezantojë gjetjet kryesore të sondazhit, duke evidentuar aspekte pozitive dhe shqetësimet e ngritura nga të anketuarit. Në përfundim, do të ofrohen rekomandime për të siguruar një zbatim sa më efikas të kësaj iniciative, me synimin që ajo të sjellë përfitime afatgjata për nxënësit dhe komunitetin në tërësi.

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet, pritshmëritë dhe rekomandimet e prindërve për iniciativën e Bashkisë Tiranë “Ushqimi falas në shkolla”.

Objektivat e sondazhit:

- a) Të evidentohet nëse prindërit kanë dijeni për iniciativën;
- b) Interesi i prindërve për zbatimin e iniciativës;
- c) Opinionet për përshtatshmërinë dhe ndikimin në mirëqenien e fëmijëve;
- d) Rekomandimet e prindërve për aktivitete shtesë;
- e) Sugjerime dhe komente.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës **06 – 14 shkurt 2025** dhe u anketuan 330 prindër. Anketimi u krye nëpërmjet **intervistave ballë për ballë** me prindër rastësorë në 11 shkolla publike 9-vjeçare të Tiranës¹, nëpërmjet një pyetëso² të strukturuar me pyetje të mbyllura dhe të hapura.

Demografia


Të anketuarit për këtë sondazh janë banorë të njësive administrative urbane (30 për secilën njësi), nga të cilët 52% janë femra dhe 48% meshkuj (*Grafiku Nr.1*).

¹ Aneks I – Shkollat ku është zhvilluar anketimi

² Aneks II – Pyetëso² i sondazhit




Anketimi është zhvilluar me prindër të nxënësve të klasave 1 deri në 5, prej të cilëve 33% janë prindër të nxënësve të klasës së 3-të, 21% të klasës së 2-të, 20% të klasës së 4-t, 17% të klasës së 5-të dhe 10% të klasës së 1-rë (*Grafiku Nr.2*).




Rezultate

52% e të anketuarve kanë *dijeni për iniciativën*, 27% nuk kanë dëgjuar më parë për këtë iniciativë, ndërsa 21% kanë informacion më të plotë (*Grafiku Nr.3*).




Të pyetur nëse dëshirojnë që fëmijët të përfitojnë ushqim falas në shkollë, 66% e mirëpresin këtë iniciativë, 24% janë shprehur se nuk u duket e nevojshme, ndërsa 10% janë dakord por me disa kushte (Grafiku Nr.4).




Kushtet që prindërit kanë evidentuar:

- Të mos serviren ushqime të shpejta (sanduiçe etj.);
- Të ketë shumëllojshmëri ushqimesh;
- Të jetë ushqim i mirëkontrolluar (siguria ushqimore, higjiena etj.).

Përveç ushqimit falas iniciativa parashikon edhe *qëndrimin e fëmijëve në mjediset e shkollës deri në orën 16:00*. 31% e prindërve janë shprehur se ky orar është mesatarisht i përshtatshëm, 28% e cilësojnë shumë të përshtatshëm, 24% të përshtatshëm, 12% të papërshtatshëm, ndërsa 5% aspak të përshtatshëm (Grafiku Nr.5).




63% e prindërve të anketuar janë plotësisht dakord me *zbatimin e kësaj iniciative*, 30% nuk janë të sigurt, ndërsa 7% janë dakord por kanë shprehur disa shqetësime (Grafiku Nr.6).




Shqetësimet e evidentuara për iniciativën:

- Alergji të mundshme ndaj ushqimeve, të plotësohet paraprakisht një formular nga familja ose të kryhen analiza;
- Prindërit e kanë të paqartë si do të qëndrojnë fëmijët në mjediset e shkollave që funksionojnë me turne;
- Informacion se ku do të konsumohet ushqimi pasi shkollat nuk kanë mensa.

Sipas të anketuarve *ndikimet e pritshme të kësaj iniciative* janë: reduktimi i stresit për organizimin e ushqimit ditor (59%), lehtësi ekonomike për familjen (55%), rritje e përqendrimit dhe performancës akademike (45%), përmirësim në shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijëve (31%), ndërsa 27% janë shprehur se nuk presin ndonjë ndikim të madh (*Grafiku Nr.7*).




Të anketuarit janë shprehur se janë të interesuar për *aktivitete shitesë gjatë orarit të qëndrimit në shkollë*: mësimet shitesë dhe ndihmë për detyrat e shtëpisë (68%), aktivitete sportive dhe rekreative (59%), aktivitete artistike (51%), edukim mbi jetën e shëndetshme dhe ushqyerjen (25%) (*Grafiku Nr.8*).



- Prindërit janë shprehur se duhen mirëmbledhur mbikëqyrja dhe vëmendja ndaj fëmijëve përgjatë orarit të qëndrimit në mjediset e shkollës dhe zhvillimit të aktiviteteve

Të pyetur se sa e rëndësishme është që shkollat publike të ndjekin standardet e arsimit europian, 43% janë përgjigjur se është shumë e rëndësishme, 42% e rëndësishme, 13% mesatarisht e rëndësishme etj. (Grafiku Nr.9).



Rekomandime

- Të mos serviren ushqime të shpejta (sanduiçe etj.), dhe të ketë shumëllojshmëri ushqimesh
- Ushqim i të jetë i mirëkontrolluar (siguria ushqimore, higjiena etj.)
- Të plotësohet paraprakisht një formular nga familja për alergji të mundshme ndaj ushqimeve ose të kryhen analiza
- Prindërit e kanë të paqartë si do të qëndrojnë fëmijët në mjediset e shkollave që funksionojnë me turne, si dhe kërkojnë informacion se ku do të konsumohet ushqimi në shkollat që nuk kanë mensa
- Prindërit janë shprehur se duhen mirëmenduar mbikëqyrja dhe vëmendja ndaj fëmijëve përgjatë orarit të qëndrimit në mjediset e shkollës dhe zhvillimit të aktiviteteve

Aneks I – Shkollat ku është zhvilluar anketimi

Nr. Rendor	Shkollat 9-vjeçare	Njësia Administrative	Pyetësorë
1	ALI DEMI	1	30
2	KOSOVA	2	30
3	XHEZMI DELLI	3	30
4	ARDIAN KLOSI	4	30
5	EMIN DURAKU	5	30
6	LASGUSH PORADECI	6	30
7	DHORA LEKA	7	30
8	KIÇO BLUSHI	8	30
9	HASAN VOGLI	9	30
10	AVNI RUSTEMI	10	30
11	ANDREA STEFANI	11	30
Total pyetësorë			330

Aneks II – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Tiranë, më ____/____/2025

PYETËSOR – Ushqimi falas në shkollë

<i>Nj. Administrative/Lagje</i>	<i>Gjinia</i>		<i>Shkolla</i>	<i>Klasa</i>
	F	M		

1. A keni dëgjuar për iniciativën “Ushqimi falas në shkollë”?

(Bashkia Tiranë do të ofrojë ushqim falas për fëmijët e ciklit të ulët në shkollat publike dhe qëndrimin në mjediset e shkollës deri në orën 16:00)

- ☐ Po, kam informacion
☐ Po, kam dëgjuar diçka
☐ Jo, nuk kam dëgjuar më parë

2. A do të dëshironit që fëmija juaj të përfitonte ushqim falas në shkollë?

- ☐ Po, patjetër
☐ Jo, nuk më duket e nevojshme
☐ Po, por me disa kushte (*Specifikoni*): _____

3. Sa i përshtatshëm mendoni se është orari deri në orën 16:00 për fëmijën tuaj?

- ☐ Shumë i përshtatshëm
☐ I përshtatshëm
☐ Mesatarisht i përshtatshëm
☐ I papërshtatshëm
☐ Aspak i përshtatshëm

4. A e mbështesni implementimin e kësaj iniciative?

- ☐ Po, plotësisht
- ☐ Nuk jam i sigurt
- ☐ Po, por kam disa shqetësime (*Specifikoni*): _____

5. Çfarë ndikimi prisni që të ketë ushqimi falas në mirëqenien e fëmijës tuaj?

(Mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

- ☐ Përmirësim në shëndetin dhe ushqyerjen e fëmijës
- ☐ Rritje e përqendrimit dhe performancës akademike
- ☐ Lehtësi ekonomike për familjen
- ☐ Reduktim i stresit për organizimin e ushqimit ditor
- ☐ Nuk pres ndonjë ndikim të madh
- ☐ Të tjera: _____

6. Çfarë aktiviteteve shtesë do të dëshironit që të përfshiheshin gjatë orarit të zgjatur?

(Mund të zgjidhni më shumë se një opsion)

- ☐ Aktivitete sportive dhe rekreative
- ☐ Mësime shtesë ose ndihmë për detyrat e shtëpisë
- ☐ Aktivitetet artistike (muzikë, art, etj.)
- ☐ Edukim mbi jetën e shëndetshme dhe ushqyerjen
- ☐ Të tjera: _____

7. Sa e rëndësishme është për ju që shkollat publike të ndjekin standardet e arsimit evropian?

- ☐ Shumë e rëndësishme
- ☐ E rëndësishme
- ☐ Mesatarisht e rëndësishme
- ☐ E parëndësishme
- ☐ Aspak e rëndësishme

8. A keni ndonjë koment ose sugjerim shtesë në lidhje me këtë iniciativë?

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet e prindërve për iniciativën e Bashkisë Tiranë Ushqimi falas në shkolla.

Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.